

VENDIM
Nr. 27, datë 20.5.2016

PËR SHPALLJEN E THIRRJES SË DYTË, PËR VITIN 2016, PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE, NGA GRANTI I ARSIMIT, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së dytë, për financimin e projekteve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1. Granti 2: “Arsimi”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I.

1.2. Drejtimet e thirrjes për financim, janë për:

a) shtim të kapaciteteve pritëse arsimore në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm, për të siguruar përballimin e kërkesës dhe për të mundësuar funksionimin brenda standardeve të mësimdhënies dhe mësimnxënies, kryesisht në zonat e mëdha urbane;

b) rehabilitim të objekteve arsimore ekzistuese, të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm, të cilat janë në rrezik shembjeje apo kanë nevojë emergjente për ndërhyrje dhe rijetëzimi i terreneve sportive të shkollave;

c) mbështetje për arsimin e lartë dhe atë pasuniversitar, ngritja dhe fuqizimi i qendrave të dijes, forcimi i kapaciteteve arsimore.

2. Për drejtimet sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1.2, të këtij vendimi, vlera e financimit të projekteve të reja, për vitin 2016, është 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

3. Aplikimi për financimin e projekteve të përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1.2, të këtij vendimi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, dhe institucionet përkatëse për projekte të arsimit të lartë, sipas shtojcave I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Procedura e vlerësimit të projekteve të aplikuara, kryhet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, sipas kriterëve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohet ministri i Arsimit dhe Sporteve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

SHTOJCË I

KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja në grantin, programin dhe shtyllën e financimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

6 qershor 2016 (afat për projektet e pikës 1.2/a, b dhe c)	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi <i>on-line</i> në faqen elektronike të e-albania: Shërbimi: Aplikimi online për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 . ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, si më poshtë vijon: a) Shtylla 1 - “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”, - granti 2: “Arsimi”, sekretariati teknik pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por vetëm pranë sekretariatit teknik.
5 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim.
3 ditë pune nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik)	Në bashkëpunim me sekretariatit teknik organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

SHTOJCË II

FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	
Shtylla e Financimit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”) dhe vendimit përkatës të KZHR-së.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”) dhe vendimit përkatës të KZHR-së.
Granti i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin grant aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”) dhe vendimit përkatës të KZHR-së.
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblotur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërrhyrjeve të reja në objektin ekzistues (nëse ka); - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; Informacion në lidhje me pronësinë e tokës (në qoftë se parashikohet ndërtimi i një objekti të ri) dhe lirimi i sheshit të ndërtimit, nëse krijon vonesa në zbatimin e punimeve, krijon kosto shtesë (kosto e shpronësimit), si dhe deklarinimin mbi zgjidhjet për mbulimin e koston të shpronësimit (në formular).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti për të njëjtin program, renditimi projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet, nëse për këtë projekt aplikuesi parashikon dhe deklaron (në formular) se mbulon: - Koston për mirëmbajtjen e objektit, dhe në rast objektsh të reja edhe koston e pajisjeve dhe shpenzimet operative, pas zbatimit të tij.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, vlera që kërkohet për financim është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore, donatorë apo nga organizata të tjera zhvillimi.
Financim nga donatorë (opsionale, nqs ka donatore)	Të jepet vlera e bashkëfinancimit në monedhën lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	

Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim (opsionale)	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Deklarime (*)	Aplikanti deklaron se: i) projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve; ii) projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit, dhe/ose të investimeve. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues siguron pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislationit të fuqi; iii) janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislationi në fuqi për përlogaritjen e koston dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike etj. (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit; - preventivin; - argumentimin teknik (relacioni).
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendndodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, në formë teksti
Foto – gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin JPEG ose PDF.
Pamje 3 dimensionale (*) i detyrueshëm përveç programit “Shqipëria dixhitale”	Imazhe në formatin JPEG ose PDF.

Shënim. Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

a) Aplikimi *online* në faqen elektronike të *e-Albania*. Shërbimi: Aplikimi *online* për FZHR-në (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>).

ose

b) Me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik përkatës.

SHTOJCA III KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE (Shtylla 1 e financimit: zhvillimi vendor dhe rajonal)

A. Kriteret e vlerësimit teknik për projektet

Këto kriteret përdoren nga sekretariati teknik për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 90 pikë**. Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas aneksit 3, të ligjit nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”. Këto kriteret konsistojnë në vlerësimin e domosdoshëm për të propozuar një projekt për financim.

Kriteret për vlerësimin e projekteve për financim janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike e aplikimit dhe e kostimit, vlerësimi financiar (oportuniteti i financimit) i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.

2. Përputhja me politikën, drejtimit e thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.

3. Ndikimi i projektit në shërbimin arsimor të ofruar, në shtimin e kapaciteteve dhe nevojën e ngutshme, në cilësinë e strukturave pritëse arsimore, në përmirësimin e perspektivës për arsimin dhe përdorimin e zhvillimin e aftësive, numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.

4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

5. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, dhe në rast objekteve të reja edhe kostoja e pajisjeve dhe shpenzimet operative, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri **bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

6. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Vlerësimi sipas këtij kriteri **bëhet me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

B. Kriteret e vlerësimit të impaktit

Sekretariati i Përgjithshëm kryen vlerësimin e impaktit të përgjithshëm të projektit, **me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.**

Shënim. Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi teknik, ligjor dhe financiar i projekteve, në zbatim të ligjit për buxhetin dhe vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, kryhet nga sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas kriterëve të përcaktuara këtë shtojcë.

2. Sekretariati teknik i paraqet Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, listën e plotë të projekteve që propozohen për financim, në përfundim të procesit të vlerësimit.

3. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në bashkëpunim me sekretariatit teknik, merr masat për organizimin e mbledhjes së Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas komunikimit zyrtar të sekretariatit teknik.

